

SPECIFIKIME TEKNIKE

MUFTE KABLLI TU ME TERMOTKURRJE

1. Te pergjitheshme

Ky specifikim percakton kerkesat per prodhimin, furnizimin dhe testimin e mufteve me termotkurje per perdorim ne rrjetin e tensionit te ulet ne ambient te brendshem, te jashtem apo nentoke. Ky material mbulon specifikimet teknike duke perfshire:

2. Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:
 Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
 Te dhena teknike te kerkuara dhe specifikime teknike
 Te gjitha test raportet e fabrikes
 Skicat me dimensione
 Manual te instalimit
 Te kene marketim CE

3. Kushtet e sistemit

a	Te dhena per sistemin	Unit	Value
1	Tensioni me I larte i sistemit	kV	0.66
2	Tensioni nominal	V	400
3	Frekuenca	Hz	50
4	Numri I fazeve	Nr	3 faze/4percjelles
5	Sistemi I tokezimit		Direkt ne toke

b	Kushtet atmosferike	
1	Temperatura maks. e ambientit	40 °C
2	Temperatura min. e ambientit	-10 °C
3	Lageshtia relative maks.	80%
4	Lartesia maks nga niveli I detit	1000m

4. Pershkrim, kerkesa dhe te dhena

Konstruksioni i mufteve duhet te rigjeneroj elektrikisht dhe mekanikisht konstruksionin e vet kabllit.

Muftet e tensionit te ulet jane te perbera nga kater tuba te brendshem me termotkurje dhe nje te jashtem po me termotkurje. Bashkueset (gilzat me bulon) realizojne lidhjen elektrike te percjellesave. Koka e bulonit duhet te keputet kur arihet shtrengimi i duhur. Tubat izolues te brendshem duhet te jene te veshur nga brenda me lendë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrire gjate nxehtësisë, duhet te realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kabllit. Tubi i jashtem me termotkurje dhe ngjitje duhet te jetë i veshur nga brenda me lendë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrire gjate nxehtësisë, duhet te realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me mbulesen e jashtme te kabllit.

Struktura kristalore e veshjeve izoluese duhet te lejoje perdorimin e temperaturave sa me te larta gjate realizimit, si edhe njekohesisht t'i pergjigjet njelloj zgjerimit termik te vete kabllit gjate shfrytezimit. Veshja e jashtme, pas termotkurjes, duhet te jete e qendrusjme ndaj goditjeve mekanike dhe agjenteve atmosferike, te mos ndikohet nga mjediset kimike, acide apo bazike, te kete qendrueshmeri te larte ndaj rezatimit ultraviolet, per te mos lejuar vjeterim te shpejte te materialit.

Bashkueset metalike (gilzat me bulon) duhet te jene pjese e setit. Ato duhet te jene te pershtateshme per te realizuar bashkimin e percjellesave alumin ose baker.

Te dhena teknike

Seksioni i percjellesit te kabllit TU (mm ²)	Dimensionet e bashkueses (mm)		Dimensionet e izolueseve te dejeve (mm)		Dimensionet e muftes (mm)	
	Diametri (mm)	Gjatesia (mm)	Diametri (mm)	Gjatesia (mm)	Diametri (mm)	Gjatesia (mm)
25 – 95	24	60	33	250	100	700
120 - 150	28	70	33	250	100	700

5. Perdorimi

Muftet jane ndertuar per tu perdorur ne kabllot e TU me 4 deje.

6. Vendet e perdorimit

Muftet TU duhet te perdoren ne te gjithë territorin

7. Standartet referuese

Muftet TU me termo-tkurrije duhet te prodhohen konform standarteve te meposhtme: **DIN EN 50393, VDE 0278 part 393**, ose standartet e tjera ekuivalente.

8. Paketimi

Muftet TU me termotkurrije duhet te paketohen ne kuti kartoni.

Ne secilen kuti kartoni duhet te shenohet:

- Emri I prodhuesit
- Seksioni (mm²)
- numri, seksioni terthor dhe diametri I percjellesve dhe I kabllit
- tensioni izolimit (1000 V)
- lloji I materialit izolues

9. Testet

Te gjitha testet duhet te kryhen ne perputhje me **DIN EN 50393, VDE 0278 part 393** ose standartet e tyre ekuivalente.